

Bashkia e Tiranës, në vijim të politikave të saj dhe në kuadër të nevojave për shërbime sociale për kategoritë në nevojë, ka ngritur 4 Qendra Sociale:

QENDRA SOCIALE "SHTËPIA E PËRBASHKËT", me vendndodhje në Njësinë Administrative nr.11, krijuar me VKB nr. 4, datë 01.03.2012 ofron:

- ✓ Identifikim, vlerësim, informim dhe këshillim psiko-mediko-social për familjet në nevojë.
- ✓ Shërbime këshilluese, ndërmjetësuese lidhur me punësimin dhe aspektet ligjore.
- ✓ Terapi grupi dhe individuale për familjet me probleme sociale.
- ✓ Parandalim i braktisjes, institucionalizimit dhe trafikimit të fëmijëve.
- ✓ Parandalimi i dhunës në familje dhe trajtim psiko-social i rasteve të dhunës
- ✓ Ofrimi i vaktit të dreqës
- ✓ Shërbimi i Fizioterapisë
- ✓ Integrimi në shoqëri i familjeve me probleme sociale.
- ✓ Ndërgjegjësimi i komunitetit mbi problemet që shqetësojnë shoqërinë shqiptare dhe rritjen e pjesëmarrjes dhe angazhimit të tyre në komunitet.
- ✓ Aktivitete sociale dhe argëtuese për familjet në nevojë dhe persona AK
- ✓ Integrimi social i të rinjve përmes referimit e ndërmjetësimit për përfitim kursesh profesionale si dhe orientim dhe ndërmjetësim për punësim.

QENDRA SOCIALE MULTIDISCIPLINARE me vendndodhje në Njësinë Administrative nr. 9, krijuar me VKB nr. 62, datë 10.11.2006 ofron shërbime sociale multidisiplinare për grupet në risk:

- ✓ Identifikim, vlerësim, informim dhe këshillim psiko-mediko-social për fëmijët, individët dhe familjet në nevojë.
- ✓ Shërbime këshilluese, ndërmjetësuese lidhur me punësimin dhe aspektet ligjore.
- ✓ Vlerësim dhe diagnostikim i problemeve të zhvillimit dhe atyre somatike për fëmijët.
- ✓ Terapi grupi dhe individuale për individë me probleme sociale.
- ✓ Parandalim i braktisjes, institucionalizimit dhe trafikimit të fëmijëve.
- ✓ Aktivitete edukative për fëmijët në situatë rruge
- ✓ Parandalimi i formave të rënda të punës së fëmijëve.
- ✓ Integrimi në shoqëri i fëmijëve me probleme sociale dhe të zhvillimit.
- ✓ Ndërgjegjësimi i komunitetit mbi problemet që shqetësojnë shoqërinë shqiptare dhe rritjen e pjesëmarrjes dhe angazhimit të tyre në komunitet.
- ✓ Ndërgjegjësimi i komunitetit për zbatimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Drejtat e Njeriut.

QENDRA KOMUNITARE SHKOZË me vendndodhje në Njësinë Administrative nr. 1, krijuar me VKB nr. 60, datë 24.12.2012 ofron shërbime sociale multidisiplinare për grupet në risk:

- ✓ Identifikimit dhe vlerësimit të situatës social ekonomike të individëve në nevojë
- ✓ Informimit dhe orientimit drejt shërbimeve të ndryshme sociale, shëndetsore, juridike që ofrohen
- ✓ Asistencë ligjore në hartimin dhe përgatitjen e dokumentacionit për regjistrim, çështje emigracioni, divorci, kujdestarie, përfitimi nga programet e strehimit etj
- ✓ Këshillimit psiko-social për problemet e ndryshme sociale të familjes, dhunës, neglizhimit, fenomenit të lypjes etj
- ✓ Ndërgjegjësimit për çështje që lidhen me të drejtat e fëmijëve e të njeriut
- ✓ Asistencës telefonike për mbështetje të qytetarëve sipas nevojave të tyre
- ✓ Klasat e ingeruara për fëmijët në situatë rruge
- ✓ Ofrimi i vaktit të drekës
- ✓ Mbështetje me paketa ushqimore dhe higjeno – sanitare për familjet e fëmijëve në situatë rruge

QENDRA SOCIALE “TË QEËNDROJMË SË BASHKU” me vendndodhje në Njësinë Administrative nr. 6, krijuar me VKB nr. 62, datë 10.11.2006, ofron shërbime sociale multidisiplinare për grupet në risk:

- ✓ Seanca edukative – mësimore
- ✓ Mbështetje psiko-sociale
- ✓ Shërbimi i fizioterapisë
- ✓ Këshillim psikologjik individual dhe në grup
- ✓ Këshillim mjekësor dhe referim
- ✓ Shërbim mbështetës i specializuar për fëmijët me sindromën e Autizmit
- ✓ Trajnime, ëorkshope, takime me prindër dhe antarë të komunitetit për rritjen e kapacitetit të tyre në fushën e AK
- ✓ Takime individuale me prindërit dhe kujdestarët e tyre
- ✓ Vizita në familje
- ✓ Advokaci dhe lobim
- ✓ Ofrimi i vaktit të drekës
- ✓ Dhënie informacioni dhe asistencë direkte për problemet e tyre

- ✓ Aktivitete sociale dhe argëtuese për prindër, fëmijë, të rinj me AK dhe të moshuar
- ✓ Ofrime të kurseve profesionale rrobaqepsie për gra dhe vajza me AK
- ✓ Informimit dhe orientimit për të moshuarit drejt shërbimeve të ndryshme sociale, shëndetësore, juridike
- ✓ Pjesëmarrjen në aktivitete rekreative, sociale e kulturore të të moshuarve
- ✓ Ofrimin të shërbimit në familje për të moshuarit me nevoja të veçanta

Me propozimin e Drejtorisë së Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale janë miratuar "Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore për Bashkinë Tiranë (2018 – 2020)" VKB nr. 69, datë 07.06.2018 dhe VKB nr. 4, datë 31.01.2018 "Planin e Zhvillimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë Tiranë (2018 – 2020).

Gjithashtu, Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale ka propozuar draft "Planin e Përfshirjes Sociale", "Planin Social Lokal" si dhe "Planin e Mbrojtjes së Fëmijëve" të cilat priten të miratohen në një periudhë të afërt.

Për një informacion më të detajuar, vendimet e lartpërmendura, mund ti aksesoni elektronikisht në faqen zyrtare të Bashkisë Tiravë: www.tirana.al